

SFIDAT GJATË MËSIMIT ONLINE DHE MOTIVIMI I MËSIMDHËNËSVE NË  
SHKOLLAT E MESME DHE FILLORE NË PERIUdhËN E PANDEMISË COVID- 19

MASTER I ARTEVE NË PROGRAMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

Nga:

FATLINDA SADIKU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË MASTER  
PRISHTINË

KORRIK, 2021

Sfidat gjatë Mësimit Online dhe Motivimi i Mësimdhënësve në Shkollat e Mesme dhe Fillore në  
Periudhën e Pandemisë Covid- 19

Fatlinda Sadiku

Mentor: Prof. Aliriza Arënliu

Qëllimi i këtij studimi është që të shikoj sfidat dhe motivimin e mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme në komunën e Vitisë. Për të përshkruar marrëdhënien ndërmjet sfidave të përdorimit të teknologjisë dhe motivimit të mësimdhënësve është përdorur metoda sasiore. Instrument i përdorur është pyetësi i ndarë në tri sesione. Ky studim është korrelacional i cili është realizuar me N= 116 pjesëmarrës, prej tyre (N= 57 ose 49.14%) pjesëmarrës ishin femra, ndërsa (N= 59 ose 50.86%) pjesëmarrës ishin meshkuj. Pjesëmarrësit ishin prej niveleve të ndryshme të edukimit (N= 3 ose 2.59%) nivelin bachelor, (N= 46 ose 39.66) studimet master, (N= 62 ose 53.45%) dhe studimet e doktorates (N= 4 ose 3.45%).

Studimi do përpiqet t'u përgjigjet pyetjeve kërkimore të cilat janë: si ndikon të mësuarit në distancë në motivimin e mësimdhënësve, pastaj a ndikon përdorimi i teknologjisë në zhvillimin profesional të mësimdhënësve, dhe cilat janë sfidat e përdorimit të teknologjisë në motivimin e mësimdhënësve? Hipotezat për këtë studim të cilat priten të mbështeten janë: të mësuarit online ka ndikim negativ në motivimin e mësimdhënësve., pastaj qëndrimet pozitive ndaj avancimit dhe zhvillimit profesional gjatë të mësuarit online ndikojnë në ngritjen e motivimit të mësimdhënësve, dhe pengesat teknike për përdorimin të teknologjisë gjatë të mësuarit online ndikojnë negativisht në motivimin e mësimdhënësve.

Përhapja globale e pandemisë COVID-19, rezultoi me ndikim në metodën konvencionale të mësuarit të institucioneve akademike, si në kontekstin global ashtu edhe në atë lokal. Ky ndryshim rezultoi që mësimi të zhvillohet në platformën online. Natyra e mësimit online duke

përfshi të gjitha pengesat e shfaqura gjatë realizimit të mësimit është konsideruar sfidë për mësime të mësimdhënësve. Sfidat me të cilat janë përballur mësime të mësimdhënësve në Kosovë në mjedisin online përfshinin dy çështje: pengesat teknike dhe ndërveprimi me nxënësit.

Këto sfida përfshirë edhe ndryshimet e menjëhershme kanë pasur ndikim edhe tek motivimi i mësime të mësimdhënësve. Motivimi i lartë ishte thelbësor për mësime të mësimdhënësve që të përballën me kompleksitetin e shfaqur në klasat virtuale. Kështu, në fushën e sociale, hulumtimet me mësime të mësimdhënësve gjatë mësimit online në periudhën e Pandemisë Covid- 19, janë të rëndësishme së veçantë pasi që konsiderohen si faktor kritik në procesin e një mësime të mësimdhënësve sa më efektive. Në Kosovë, mungesa e njohurive të përdorimit të teknologjisë nga mësime të mësimdhënësve ka paraqitur sfida duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejt në motivimin e tyre gjatë punës. Prandaj edhe hulumtimi ka fokusin në sfidat dhe motivimin e mësime të mësimdhënësve gjatë mësimit online.

Rezultatet e raportuara treguan korrelacione të ndryshme në raport me motivimin e mësime të mësimdhënësve. Sfidat e përdorimit të teknologjisë kishin korrelacion më të fuqishëm me mungesën e ndërveprimit në klasë ( $r = .40, p = .00$ ), ndërsa sfidat e përdorimit të teknologjisë nuk tregoi korrelacion me mendësin e rritjes së mësime të mësimdhënësve ( $r = .11, p = .22$ ). Njohurit e përdorimit të teknologjisë kishin korrelacion më të lartë me motivimin e mësime të mësimdhënësve ( $r = .46, p = .00$ ), poashtu njohurit e përdorimit të teknologjisë kishin korrelacion edhe me pozitivitetin profesional të mësime të mësimdhënësve ( $r = .32, p = .01$ ). Mungesa e ndërveprimit me nxënësit gjatë të mësuarit online tregon korrelacion më të lartë me pozitivitetin profesional që bazohet në interesimin e mësime të mësimdhënësve për tu përmirësuar gjatë karrierës ( $r = .31, p = .01$ ), mirëpo mungesa e ndërveprimit me nxënësit kishin edhe korrelacion të lartë me lodhjen emocionale ( $r = .30, p = .02$ ). Lodhja emocionale kishin një korrelacion të moderuar me mendësin e rritjes së mësime të mësimdhënësve, por ishte korrelacioni më i lartë në raport me aspektet tjera të motivimit ( $r = .23,$

$p = .03$ ). Në analizën e korrelacionit është vërtetuar hipoteza e dytë se pozitiviteti profesional drejtë zhvillimit dhe avancimit profesional kishte korrelacion të lartë me motivimin e mësimit në mesimdhënësve që bazohet në përkushtimin e profesionit ( $r = .56, p = .00$ ).

Sipas të gjeturave mësimi online ka ndikim negativ në motivimin e mësimit në mesimdhënësve, pasi që mungesa e njohurive të përdorimit të teknologjisë është parë si faktor kyqë në motivimin e mësimit në mesimdhënësve. Si rezultat i mungesës së njohurive në përdorimin e teknologjisë, ka munguar edhe ndërveprimi me nxënës gjatë mësimit online, dhe kjo ka predikuar lodhjen emocionale tek mësimit në mesimdhënësit. Mirëpo, ajo që ka ndikuar në ngritjen e motivimit të mësimit në mesimdhënësve ishin qëndrimet positive ndaj avancimit dhe zhvillimit profesional që i referohet zhvillimit gjatë karrierës dhe pozitiviteti profesional. Të gjitha këto pengesa përfshirë ato teknike, kushtëzimi i nxënësve për të qenë pjesëmarrës dhe ruajtja e entuziazmit të nxënësve për të mësuar, kanë ndikuar negativisht në perceptimin e mësimit në mesimdhënësve për arritjen e objektivave gjatë të mësimit online (Samsudin. A, 2020)

Bazuar në të gjeturat e studimit, për realizimin e një mësimit më efektive në platformën online, si për mësimit në mesimdhënësit ashtu edhe për nxënësit, është i nevojshëm një kompleks ndërhyrjesh në fusha të ndryshme. Në radhë të parë në fushën e studimeve sociale duhet të kemi një studim më të detajizuar rreth sfidave të mësimit në mesimdhënësve dhe karakteristikave të tyre në raport me mësimit online. Si dhe të përdoren metoda alternative për mbledhjen e të dhënave, si intervistat e gjymëstruara me qëllim të përmbledhjes së perceptimit të mësimit në mesimdhënësve për sfidat gjatë mësimit online dhe mësimit prezent në klasë.

Pastaj në fushën institucionale duhet të ngritet në nivel lokal një strukturë e veçantë, për trajnimin e mësimit në mesimdhënësve për njohurit dhe shkathtësitë kompjuterike. Poashtu të ngritet një sistem regjistrimi i faktorëve ndërmjetësues tek mësimit në mesimdhënësit, si niveli i pagës apo norma e

orëve. Ndërsa në fushën e politikave shkollore përmes gjetjeve të bazuara në studim dhe nëpërmjet përmes shërbimit psikologjik në shkollë të shikohen edhe variablat ndërmjetësuese si personaliteti i mësimitdhënësve që ndërlidhen me përceptimin e sfidave dhe motivimit gjatë mësimit online. Pastaj, të zhvillohen politika dhe programe shkollore, që t'i trajtojnë faktorët themelorë që ndikojnë në lodhjen emocionale të mësimitdhënësve, dhe të ngriten mekanizma nga liderët e shkollave për monitorimin e zhvillimit të procesit mësues.